



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Data 12.08.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Sistemi i votimit elektronik dhe transmetimit te rezultateve”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kamera video 32333200-8

Mikrofonë 32341000-5

Ekrane projektimi 38653400-1

Pajisje për sisteme komandimi dhe kontrolli, printimi, grafike, automatizim
zyrash dhe procesim informacioni 42960000-3

Komplete paketash software 48422000-2

VLERA E FONDIT LIMIT:

2,750,000 (dy milion e shtateqind e pesedhjetë mijë) leke, pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor BASHKIA KORÇE ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022,2023,2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40%** e vlerës të parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i shterben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete jo më e vogël se 40 % të vlerës të përlogaritur të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2c dhe nenin 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ligjin nr. 29/2023 Për Tatimin mbi të Ardhurat, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje Nenin 61 të ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”: 1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20 %** të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomikë.

Pika 2.2.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

-Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % e vlerës të përlogaritur të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme gjatë realizimit të objektit të kontratës, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- NS 13 A *Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni*.

- NS 14 A *Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj*

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në Nr. 42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 40, pika 5/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"; ligjin nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridik që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar,

Kërkesa për paraqitjen e licencës profesionale për kategoritë NS 13 A dhe NS 14 A, në rastin e këtij objekti prokurimi, është e arsyeshme dhe e domosdoshme për këto arsye:

Objekti përfshin jo vetëm pajisje elektronike dhe software, por edhe instalimin e sistemeve komplekse elektronike, audio, video dhe telekomunikacionit (kamera PTZ, mixer audio, amplifikator, kabllot, monitorë, etj.), që kërkojnë ndërhyrje teknike dhe infrastrukturore në ambientet ku do të instalohen. Kjo i fut këto punime në fushën e veprimtarisë ndërtimore dhe teknike sipas ligjit të ndërtimit.

Licenca garanton që operatori ekonomik ka kapacitetin teknik dhe profesional për të kryer punime në fushën e impianteve elektrike dhe telekomunikacionit (NS 14 A dhe NS 13 A), duke respektuar standardet e sigurisë dhe cilësisë, që është thelbësore për funksionimin e saktë të sistemit të votimit elektronik.

Ligji nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridik që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar, përcaktojnë qartë se çdo subjekt që realizon punime montimi, mirëmbajtje dhe ristrukturimi të linjave telefonike të jashtme dhe impianteve të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni dhe TV përfshirë gjithashtu punimet ndihmëse ose plotësuese të muraturës, të ndara nga sistemet e tjera të realizuara në punimet e përgjithshme, duhet të jetë i licencuar sipas kategorive NS 13 dhe NS 14. Kjo siguron disiplinën dhe kontrollin në realizimin e punimeve.

Kërkesa për nivelin A të licencës profesionale në kategoritë NS 13 A dhe NS 14 A është e bazuar në vlerën e punimeve të parashikuara në preventiv, të cilat nuk tejkalojnë 20 milionë lekë.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e objektit të kontratës, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave si më poshtë:

a) Inxhinier Elektronik 1 (një)

Per te vertetuar personelin kryesor duhet:

I. Diploma

II. Kontrata e punës së vlefshme

III. CV

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

Eshte kerkuar Inxhinier elektronik, për shkak të natyrës teknike të instalimeve, audio dhe telekomunikacionit, si dhe për të garantuar zbatimin korrekt të punimeve dhe sigurinë e instalimeve.

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- | | |
|--------------------|---------|
| 1. IT/Informatike | 1 (një) |
| 2. Teknik elektrik | 1 (një) |

Per punonjësit e sipërcituar duhet të dorëzohen:

1. Diploma ose certifikate
2. Kontrata e punes e vlefshme
3. CV

- | | |
|---|---------|
| 3. Punonjës i certifikuar si Specialist i Rrjetit Kompjuterik | 1 (një) |
| 4. Punonjës i certifikuar si Specialist në Teknologjinë e Mbrotjtjes së Rrjetit dhe Aplikacioneve | 1 (një) |
| 5. Punonjës i certifikuar për Sistemet Audio–Video të Konferencave | 1 (një) |

Per punonjësit e sipërcituar duhet të dorëzohen:

1. Certifikatat përkatëse, të lëshuara nga qendra formimi profesional publike ose private të licencuara, nga institucione arsimore të akredituara ose nga prodhues/distributorë zyrtarë ose qendra trajnimit të certifikuara ndërkombëtarisht, sipas fushës përkatëse;
2. Kontratë pune e vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e

nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht: Objekti i kësaj procedure përfshin pajisje dhe sisteme me nivel të lartë teknologjik në fushën e rrjeteve kompjuterike, sigurisë së rrjetit dhe sistemeve audio–video për konferenca, të cilat kërkojnë instalim, konfigurim dhe mirëmbajtje nga personel me njohuri të specializuara dhe të certifikuara. Përbushja e këtij kriteri garanton që operatori ekonomik zotëron kapacitetin profesional për të kryer me cilësi dhe brenda afateve të përcaktuara punimet/ shërbimet objekt të kontratës.

Eshte kerkuar Specialist IT/Informatikë, për menaxhimin e instalimit te sistemit të votimit elektronik, software-it të avancuar, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve kompjuterike dhe rrjetëzimit, duke siguruar funksionimin optimal dhe integrimin e sistemeve informatike.

Eshte kerkuar Tekniku elektrik sepse pjesa më e madhe e pajisjeve dhe instalimeve (kamera, amplifikatorë, mixer audio, kabllo, monitorë etj.) lidhen me sistemet elektrike dhe energjetike që kërkojnë njohuri të thella për instalime të sigurta dhe standarde elektrike; menaxhim të tensioneve, ngarkesave dhe mbrojtje nga rreziqet elektrike; garantimin e funksionimit korrekt dhe pa defekte të pajisjeve në bazë të normave teknike,

Kërkesa për certifikata të lëshuara nga qendra formimi profesional publike ose private të licencuara, institucione arsimore të akredituara, apo nga prodhues/distributorë zyrtarë ose qendra trajnimi të certifikuara ndërkombëtarisht, siguron që personeli i angazhuar ka marrë trajnim të strukturuar, të verifikuar dhe të njohur zyrtarisht në fushën përkatëse. Kjo redukton rrezikun e gabimeve teknike, defekteve gjatë instalimit apo konfigurimit dhe vonesave në realizimin e kontratës.

Gjithashtu, kërkesa që punonjësit të figurojnë në listë–pagesat e muajit të fundit dhe të kenë kontratë pune të vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës siguron që ata janë pjesë reale e strukturës së operatorit ekonomik dhe do të jenë të angazhuar gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, duke garantuar vazhdimësi dhe përgjegjësi teknike.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.3.1 Operatori ekonomik duhet te paraqesë **autorizim prodhuesi ose autorizim distributori** per zerat e mallrave sipas tabelës së mëposhtme. Në rast se do të paraqitet autorizim distributori duhet të provohet dhe lidhja midis prodhuesit dhe distributorit, nepermjet kontratës ose dokumentit të angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit. Secili nga dokumentat duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave si dhe origjinale ose fotokopje të noterizuara.

Emertimet e mallrave në tabelën e mëposhtme për të cilat duhet të paraqiten autorizim prodhuesi ose autorizim distributori, i perkasin **zerave 1,2,4,5 dhe 9** të preventivit të Shtojcës nr.7 ”Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit” në DST.

Tabela me zerat e mallrave për të cilat duhet të paraqiten autorizim prodhuesi ose autorizim distributori:

Nr.	Emertimi i mallrave
1	Pajisje qendrore e Konferencës

2	Njesi Drejtuesi
4	Mixer Audio Racmount
5	Amplifikator Dixhital Profesional
9	Kamera PTZ

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; pika 8, e nenit 40, të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar ku është e cituar: *8.Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës*”, si dhe duke iu referuar për analogji vendimeve të KPP-se dhe rekomandimeve të APP-se, Autoriteti Kontraktor ka gjykuar që të paraqitet autorizim prodhuesi ose autorizim distributori për disa mallra objekt prokurimi.

Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim, i garanton gjithashtu AK se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikëpamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve më të larta nga prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës si dhe që do vijojnë për të zbatuar kushtet e garancisë.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose të distributorit është vendosur vetëm për produktet e listuara në tabelë, pasi këto pajisje përbëjnë elementët kryesorë dhe më të rëndësishëm të sistemit që do të furnizohet, si nga pikëpamja e funksionalitetit ashtu edhe e vlerës ekonomike në kuadër të kontratës. Bëhet fjalë për pajisje elektronike dhe audiovizive të specializuara, të cilat kanë një rol qendror në sigurimin e performancës së sistemit të përgjithshëm, dhe që kërkojnë cilësi të garantuar, standarde të certifikuara dhe përputhshmëri teknike me komponentët e tjerë të sistemit. Duke qenë se këto pajisje janë elementë kyç për funksionimin korrekt të gjithë instalimit, kërkesa për autorizim siguron që ato të jenë origjinale, të certifikuara dhe të përputhshme me kushtet teknike të kontratës, duke eliminuar riskun e furnizimit me produkte të pasigurta ose jo origjinale.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te paraqese katalog/katalogje ose **skeda teknike per te gjitha zerat e mallrave** objekt ne kete procedure prokurimi, te cilat duhet te perputhen me pershkrimin e bere ne specifikimet teknike. Në katalog apo skedat teknike, duhet të **markohen** (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të kërkuara në specifikimet e hartuara nga grupi i punës.

Ne rast se dokumentet e mesiperme jane në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Vendorsja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht: Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo **katalogjet teknike**

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Paraqitja e katalogjeve per te gjitha zerat e mallrave, eshte kerkuar me qellim verifikimin e perputhshmerise se mallrave qe operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike te percaktuara ne DST.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me standardet:

ISO 9001:2015, ose ekuivalente, Për sistemin e menaxhimit të cilësisë

ISO 20000-1:2018, ose ekuivalente, Teknologjia e informacionit –Menaxhimit I Sherbimit

ISO 27001:2018, ose ekuivalente, Per sistemin e menaxhimit te sigurise se informacionit

Çertifikata duhet të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

* Termi ”ekuivalent” perfshin edhe standartet SSH (nese disponohen) te adoptura nga DPA mbi bazen e atyre nderkombetare.

* Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

* Ne rast se dokumentet e mesiperme jane në gjuhë të huaj ato duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kerkesa per çertifikatat e mesiperme eshte konsideruar e nevojshme,duke patur parasysh natyren dhe vleren e objektit te prokurimit, per vertetuar se operatoret ekonomike qe do te marrin pjese ne kete procedure prokurimi permbushin standartin e cilesise per te cilen leshohet kjo çertifikate me

qëllim që autoriteti kontraktor të vertetojë përmbushjen e kontratës në përputhje me standartet e cilesise.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Nr 364 datë 10.04.2025.

Argumentimi i specifikimeve: Specifikimet janë hartuar në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për një sistem bashkëkohor, të sigurt dhe funksional të votimit elektronik, i cili garanton proces transparent, të besueshëm dhe të paanshëm, në përputhje me parimet e mirëqeverisjes dhe zhvillimit administrativ.

Ky sistem synon të përdoret për zhvillimin e votimeve brenda Këshillit Bashkiak Korçë, me qëllim modernizimin e proceseve vendimmarrëse dhe rritjen e efikasitetit në miratimin e akteve dhe vendimeve kolegjiale. Specifikimet teknike janë hartuar për të përfshirë elementët kryesorë që sigurojnë identifikimin e saktë të anëtarëve të këshillit pjesëmarrës në seancë; realizimin e votimit në mënyrë elektronike, me opsione të qarta (pro/ kundër/ abstenim); menaxhimin dhe ruajtjen e të dhënave në mënyrë të sigurt; transmetimin automatik dhe të menjëhershëm të rezultateve të votimit, me mundësi pasqyrimi në ekran të madh për publikun apo për protokollin zyrtar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e parametrave dhe karakteristikave funksionale dhe teknologjike që garantojnë cilësinë, sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit, si dhe përputhshmërinë e tij me infrastrukturën teknike aktuale të autoritetit kontraktor. Ato janë hartuar në përputhje të plotë me funksionet që sistemi pritet të përmbushë.

Në çdo rast nëse janë përmendur marka prodhimi, burim specifik apo proces i veçantë do të pranohen edhe ekuivalenti i tij/saj

NJËSIA E PROKURIMIT